



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:908200

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06154411

**Ca.nr.4794/24**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Enes Mehmeti, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Lumni Sallauka, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.Q nga fshati Bardh i Madh, Komuna e Fushë Kosovës, përfaqësuar nga av. Sani Berisha nga Prishtina, kundër të paditurit Korporata Energjetike e Kosovë, KEK Sh.A., Prishtinë me seli në Prishtinë, për pengim posedimi dhe kompensim dëmi, lidhur me ankesën e ushtruar nga i autorizuari i paditësit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.979/22 (2020:908200), i datës 30.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **10.09.2024**, ka marr këtë:

## **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** ankesa e të autorizuarit të paditësit I.Q nga fshati Bardh i Madh Komuna e Fushë Kosovës, **PRISHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.979/22, i datës 30.06.2023, dhe çështja kthehet në rivendosje.

### **A r s y e t i m i**

“Gjykata e shkallës së parë, me Aktvendimin e atakuar ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar që të VËRTETOHET se e paditura e ka penguar paditësin në shfrytëzim të qetë dhe faktik të posedimit të fundit të paluajtshmërisë së të paditurës në vendin e quajtur “Fusha e Palojes së Hirit” , në të cilën paditësi e korrte grurin e mbjellur, kështu që e paditura e ka ndaluar korrjen e mëtejme të grurit dhe e ka dëmtuar rëndë paditësin dhe të DETYROHET e paditura që brenda afatit 3 tre ditësh të mos e pengoj paditësin në korrjen e grurit të ngelur. Po ashtu është hedhur poshtë si e pa lejuar pjesa e kërkesëpadisë me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar për moslejtim të korrjes së grurit nga e paditura në sipërfaqe prej 15 H, në sasi të tërësishme të grurit

prej afro 50.0000 kg sipas çmimit te vlerësuar nga eksperti gjyqësor, me kamatë ligjore nga ushtrimi i padisë.”

Kundër Aktvendimit të datës 30.06.2023, ankesë ka parashtruar i autorizuari i paditësit me pretendimet se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që gjykata e Apelit ankesën t`a aprovojë si të bazuar ashtu që t`a ndryshoj aktgjykimin e atakuar apo t`a prishë si të kundërligjshëm dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje të shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, Aktvendimit të atakuar dhe pretendimeve ankimore, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

#### **- Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e çështjes rezulton se paditësi kundër të paditurës ka ushtruar padi për pengim posedimi dhe kompensim dëmi me pretendimet e paraqitura specifikisht si në padinë e datës 30.08.2013. Paditësi përmes parashtresës së datës 15.03.2019 ka precizuar kërkesëpadinë e tij ashtu që tani kërkon që të detyrohet e paditura t`ia kompensoj dëmin në emër të moslejimit të korrjes-fshirjes së grurit në sipërfaqe prej 15 hektarësh gjegjësisht shumën prej 16,095.00€.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e datës 12.04.2019 kishte lejuar precizimin e kërkesëpadisë së paditësit dorëzuar përmes parashtresës së datës 15.03.2019, mirëpo e njëjta përkundër lejimit të precizimit të kërkesëpadisë ajo kishte vendosur lidhur me padinë për shkak të pengim posedimit dhe njëkohësisht kishte hedhur kërkesëpadinë për kompensimin e dëmeve paditësit.

Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit Ac.nr.4721/19 datë 07.02.2022 kishte aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe çështjen e kishte kthyer në rigjykim. Udhëzimet e gjykatës së apelit konsistonin në faktin se gjykata e shkallës së parë do të duhej vlerësonte faktin nëse ndryshimi i padisë ishte i lejuar në këtë rast, pra nga padia për pengim posedimin në atë për kompensim dëmi, sikundër dhe rivlerësimi i rrethanave faktike dhe juridike lidhur me pretendimet e padisë eventuale të precizuar.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykimin e çështjes përmes aktvendimit të datës 13.06.2023 ka refuzuar precizimin e kërkesëpadisë së paditësit në këtë çështje juridike kontestimore dhe e njëjta ka vijuar me procedimin e çështjes sikur paditësi të ketë ushtruar padi për shkak të pengim posedimit ndërkohë po ashtu ka vendosur që të hudhë pjesën e kërkesëpadisë së paditësit përkritazi me kompensimin e dëmit?!

Ajo përkritazi me pjesën refuzuese ka arsyetuar vendimin e saj në drejtim të palejueshmërisë së saj duke arsyetuar se padia e paditësit për pengim posedimi është bërë jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh siç është paraparë me nenin 114 të LPDS, ndërsa përkritazi me vendosjen si në pikën dy respektivisht hudhjen e padisë për kompensim dëmi e ka arsyetuar në

kuptim të nenit 480 të LPDS, sipas të cilit përjashtohet mundësia për kërkesa materiale tek paditë për shkak të pengim posedimit.

Gjykata e Apelit, vlerëson se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhim i një procesi të parregullt gjyqësor për çka epilogu i dhënë me aktvendimin atakuar ka rezultuar si i paligjshëm, sepse i njëjti është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 pika(n) të LPK-së, kjo ngase aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos pjesa e dispozitivit të tij është i pakuptueshëm dhe kontradiktore me vetvete ose me arsyet e aktgjyqimit, dhe se në aktvendim nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare, respektivisht ato janë të paqarta dhe kontadiktore, ndaj për shkak të të metave të tilla është dashur që aktgjyqimi në fjalë të prishet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim.

Gjykata e Apelit, më rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paditësit në kontekst të vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të atakuar ka gjetur se i njëjti është nxjerr me të meta të cilat e bëjnë të parregullt dhe paligjshëm mënyrën e vendosjes .

Kolegji i kësaj gjykate në rasatin konkret ka vlerësuar se gjykata e faktik nuk ka ndjekur udhëzimet e gjykatës së Apelit për të rivlerësuar çështjen në drejtimin e duhur. Ajo është mjaftuar me faktin se me Aktvendimin e datës 13.06.2023 ka refuzuar precizimin e kërkesëpadisë së paditësit për kompensim dëmi nga padia për shkak të pengim posedimit dhe se Aktvendimin në fjalë nuk e ka arsyetuar, por ka vijuar me procedimin e çështjes në fjalë.

Pra në situatën e tillë shtrohet dilema nëse gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur ka gjykuar si në pikën (I) përkitazi me kërkesën e paditësit për shkak të pengim posedimit kur paditësi padinë e tij e ka precizuar me kërkesën e vetme kompensimin e dëmit, pra shtrohet pyetja nëse gjykata e shkallës së parë është dashur të vendos përkitazi me një kërkesë padi për pengim posedimi, kur vet paditësi e ka tërhequr në një formë të njëjtën duke e kërkuar tashmë vetëm kompensimin e dëmit, si kundër dhe më tej vërehet se gjykata e shkallës së parë ka vendosur sërish për kërkesëpadinë e paditësit, për kompensim dëmi, të cilën kërkesë respektivisht precizimin e padisë për kompensim dëmi e ka refuzuar me Aktvendimin e datës 13.06.2023.

Pra, në rastin e tillë janë evidente diskrepanca në mes asaj që pala kërkon dhe asaj çfarë gjykata ka vendosur në këtë çështje, ndërkohë që gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar fare çështjen nëse mund të ndodhte ndryshimi i padisë nga pengim posedimi tek ajo për kompensim dëmi, dhe në këtë pjesë nuk ka dhënë asnjë shpjegim. Pra, dhënia e përgjigjes në këtë pyetje determinon në masë orientimin e zgjidhjes së çështjes, mirëpo gjykata e shkallës së parë me mënyrën si ka vendosur, ka ngritur edhe më shumë dilema, për çështjen.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë duhet të rivlerësojë çështjen në fjalë në dritën e akteve iniale të çështjes si dhe parashtresës së datës 15.03.2019 dhe varësisht nëse e lejon apo jo precizimin e kërkesëpadisë atëherë të orientojë çështjen për zgjidhje gjithmonë duke ditur detyrimin për udhëzimin e palëve në përmirësimin e mjeteve juridike iniciuese të procedurës, e jo si në rastin konkret e njëjta ka vendosur edhe për padi për pengim posedimi kundrejt mungesës së kërkesës nga paditësi, për padi, për pengim posedimi (*paditësi e ka deklaruar mungesën e interesit të tij juridik për padi për pengim posedimi ndaj të paditurës*)

edhe për çështjen e kompensimit të dëmit në kundërshtim me vendimin për refuzimin e propozimit për precizimin e kërkesëpadisë për kompensim dëmi. Pra, është rasti tipik kur gjykata e faktik vendos, për një çështje, në mungesë të vet kërkesës së palës që ka iniciuar procedurën kontestimore.

Gjykata në rivendosje duhet të vlerësoj rrethanat e sipër cekura dhe pasi të orientoj drejtë procesin gjyqësor të vlerësoj meritorisht pretendimet e palës paditëse kundrejt kundërshtimeve të të paditurit në dritën e gjendjes së fakteve dhe provave të çështjes dhe të nxjerr vendim të rregullt dhe të ligjshëm.

Andaj për këto arsye në mbështetje të nenit 209 parg.1 pika (d) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË,**  
**Ca.nr.4794/24 datës 10.09.2024**

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari,**  
Enes Mehmeti